



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË – KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU	
Nr.faq/Br.str.	1051
Çatë/Datim.	09.10.2019
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE	

Në bazë të Ligjit mbi Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068 ,
UA Nr.10 / 2018 dhe në bazë të nenit 8, paragrafi 1,2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, lidhur me
kushtet dhe kriteret për themelimin e marrëdhënies së punës , Drejtori i Drejtorisë për Arsime
në Fushë Kosovë shpallë:

KONKURS për këto vende të lira

1. **Shkolla Filllore e Mesme e Ulët “ Daut Bogujevci “ Fushë Kosovë**
Dy (2) arsimtarë klasor me kohë të caktuar , deri sa të kthehen punëtorët nga
pushimi i lehonisë
2. **Shkolla Filllore e Mesme e Ulët “Bajram Curri “ Sllatinë e Madhe**
Dy (2) arsimtarë klasor në PNF Harilaç dhe PNF Henc , njeri me kohë të caktuar

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Mësim klasor në Shkollë të Mesme të Ulët:

- ☐ Fakulteti i Edukimit – programi fillor
- ☐ Fakulteti i Mësuesisë

Dokumentacioni i nevojshëm :

- Të jetë banor i Kosovës - letërnjoftimi
- CV
- Çertifikata e lindjes
- Diploma e fakultetit
- Vertetimi se nuk është nën hetime

Sqarim : Në Shkollën Filllore dhe të Mesme të Ulët (kl. 1 – 5), kandidatët duhet të kenë së paku
240 ECTS, përkatësisht studimet 4 vjeçare për mësim klasor .

Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve dhe UA nuk
do të merren në shqyrtim, gjegjësisht , do të refuzohen.

Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik, kandidatët do t'i
nënshetrohen testimit me shkrim. Testi me shkrim në maksimum tërheqë 100 pikë .

Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim, i nënshetrohen intervistimit
me gojë. Në intervistën me gojë, kandidatët mund të vlerësohen në maksimum deri 100 pikë apo
50% e vlerësimit përfundimtar.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë diploma të nostrifikuara nga MASHT-I .

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për testin me shkrim dhe intervistën me gojë si dhe të gjitha njoftimet tjera publikohen në Faqen Zyrtare të Komunës së Fushë Kosovës : <https://kk.rks-gov.net/fushekosova/> kurse kandidatët do të thirren edhe me tel ose e-mail .

Në rast të ndonjë nevoje eventuale shtesë për mësimdhënës/e në institucione shkollore, do të bëhen angazhime sipas renditjes së listave prioritare me rastin e shpalljes së rezultateve.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Afati i konkursit është deri më 20.10.2019 .

Dokumentacioni komplet dorëzohet në Arkivin e Komunës në katin përdhese , në ndërtesën e Komunës së Fushë Kosovës .

Adresa : rruga e Pejës , p.n . - Fushë Kosovë

